

VENDIM
Nr. 5, datë 22.2.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË SHA

(Ndryshuar me vendimin nr. 53, datë 20.12.2024; nr. 13, datë 30.4.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 22.2.2023 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Sektori Juridik mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. për licencim

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë (UK Tiranë) me shkresën nr. 1002 prot., datë 23.1.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesë për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Tiranë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM- në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria UK Tiranë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 862 009 banorë në Bashkinë Tiranë;

b) drejtues ligjor i shoqërisë është z. Elton Kacidhja.

c) drejtues teknik i shoqërisë është z. Edgar Çani i diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike, dega “Elektrikë”, në vitin 1985 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion, sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 958;

d) drejtues teknik i shoqërisë për impiantin është z. Enton Osmani i diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega “Mjedis”, profili “Energjetikë” në vitin 2004 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion, sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 958.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tiranë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Tiranë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a., me NUIS L72320033P në kategoritë:
 - a) kategoria A: “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”;
 - b) kategoria B: “Për përpunimin e ujit për konsum publik”;
 - c) kategoria C: “Për largimin e ujërave të ndotura”.
2. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) drejtues ligjor: *z. Skerdi Drenova*;
 - b) drejtues teknik: Edgar Çani;
 - c) drejtues teknik: Enton Osmani.
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a. është Bashkia Tiranë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani